

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str. 70		
Datë/Datum. 19.04.2018		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së tretë III-të, e rregullt, e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 30.03.2018, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Fushë-Kosovë.

Prezent në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Shaban Ademi, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Naser Graiq-evci, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Arjana Zogiani, Mehdi Lahu, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Driton Ademi, Betim Ahmeti, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Qerim Gara.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Nuriye Fazliju - Drejtore e Administratës, Abdullah Prebreza - Drejtor i PU-së, Ramadan Jashanica - Drejtor i FB-së, Jakup Tërnavë - Drejtor i GJKP-së, Nuriye Avdiu - Drejtore e KRS-së, Jakup Dumani - Drejtor i SHMS-së, Maliq Berisha - Drejtor i SHPM-së dhe Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 26.02.2018.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017.
4. Propozim për shqyrtimin e 'Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2017'.
5. Propozim për shqyrtimin e parë të taksës administrative dhe tarifës së densitetit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit për vitin 2018.
6. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosovë'.
7. Propozim për fillimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunave italiane Civita dhe Frascineto.
8. Propozim për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë.
9. Propozim për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Fushë-Kosovë.
10. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për palën Delfina Lavdim Shala.
11. Propozim për ndarjen e Mirënjohjes për veprimtarin Rexhep Gunduz.

12. Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
13. Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës për mandatin zgjedhor 2017/2021.
14. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarohen për rendin e ditës së propozuar. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e rendit të ditës së propozuar.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë (26) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet, e aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 26.02.2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 26.02.2018, hap diskutimin për vërejtjet apo sugjerimet tuaja.

Mehdi Lahu: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit sepse nuk po publikohen audioincizimet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Aida Alimi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Ne kërkojmë që të bëhet publikimi i audioincizimeve jo vetëm i ekstrakteve të procesverbaleve pas aprovimit dhe derisa nuk publikohen audioincizimet ne Grupi Parlamentar i PDK-së do të abstenojmë.

Ali Ismaili: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë nuk kam vërejtje në ekstraktin e procesverbalit por kërkoj sqarime që ta di a janë bërë pjesë e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar vërejtjet e mia dhe a është publikuar ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar në ueb-faqen e Komunës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 26.02.2018'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', tetë 'kundër' dhe asnjë 'abstenim', gjithsej njëzet (20) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 26.02.2018'.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' ju ftoj juve, anëtarë të Kuvendit të Komunës, që t'i parashtroni pyetjet tuaja, nëse keni ndonjë për Ekzekutivin e Komunës.

Mehdi Lahu: Këto ditë jemi dëshmitar të vendosjes së mishit jocilësor dhe me afat të skaduar nëpër dyqanet tona. Ky mish është vendosur në tregun tonë nga importi, pyes, a ka marrë ndonjë veprim Inspektori Sanitar për kontrollimin e depove në territorin e Komunës tonë?

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës të gjithë jemi dëshmitar që unë në mbledhjen e kaluar e kam parashtruar një pyetje për Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës në lidhje me listën e pronave komunale, atë dokumentacion e kemi kërkuar zyrtarisht edhe me shkrim dhe në afatin ligjor nuk e kemi marrë asnjë përgjigje, ndërsa sot për shqyrtim pikën e tetë dhe nëntë të rendit të ditës i kemi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ne si anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nuk e kemi listën e pronave!

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E kam një pyetje për Drejtorin e Planifikimit Urban. Në lagjen 'Dardania' në Rrugën 'Hajrullah Zymi' dhe afër shkollës 'Mihal Grameno' në rrugë rrjedhin ujërat e zeza dhe kjo paraqet rrezik për shëndetin e banorëve, andaj kërkojmë që të dilet në terren dhe të sanohet kjo gjendje!

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Ekzekutivin e Komunës, që është edhe kërkesë e banorëve të fshatit Miradi e Poshtme, a bëhen analizat e ujit nga pusi në oborrin e objektit shëndetësor, sepse banorët e përdorin atë ujë?! Pyetja e dytë është një dhimbje e madhe se si banorët e fshatit Miradi e Poshtme e bëjnë kalimin e Rrugës M9, aty nuk gjendet asnjë shenjë e komunikacionit, rrugën për automjete me muaj të tërë e merr uji, nuk mund të kalohet! Për këmbësorët duhet të merret ndonjë veprim, të ndërtohet një mbikalim i cili po ashtu paraqet problem për të moshuarit dhe fëmijët apo të vendosen semaforët. Banorët e fshatit Miradi e Poshtme kërkojnë zgjidhje dhe thonë se ne ju kemi votuar që të na ofroni zgjidhje për problemet tona. Tjetër, pronat publike nëpër fshatra a kontrollohen nga Inspektorati? Mbeturina ka kudo, tani është vendosur një deponi që nuk ka mundur të vendoset as në Mitrovicë, as në Obiliq, është vendosur në rrethin tonë, kjo është e papranueshme! Unë pyes, a ka zot shtëpie këtu, a kontrollon dikush?

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, unë si asamblist jam i shqetësuar me kërkesat e banorëve të fshatit Bardh i Madh për sigurimin e ujit të pijshëm, kërkesë elementare dhe bazike për jetën, andaj Komuna duhet të ndërmerr diçka në këtë drejtim! Më datë 28.03.2018 jam informuar se në Fushë-Kosovë një nxënës është sulmuar nga qentë endacakë, ne kemi ndarje të mjeteve financiare për këtë çështje, kërkoj që përgjegjësit që merren me këtë punë të veprojnë, ose rastin duhet ta paraqesim tek organet më të larta në nivel vendi. Problemi për kalimin e rrugës nga këmbësorët në fshatin Miradi e Poshtme, është një problem serioz, aty duhet të vendoset mbikalim, ose të vendosen semaforët, duhet të gjendet një zgjidhje.

Ali Ismaili: Unë kam një hall me Ekzekutivin e Komunës. Në mandatin e kaluar për shumicën absolute të pyetjeve tona që i kemi parashtruar në mbledhjet e Kuvendit të Komunës nuk kemi marrë përgjigje! Nuk kam marrë përgjigje as për pesë pyetjet e kaluara, as për pyetjet e fundit dhe kjo punë nuk është fare e lehtë, por në të ardhmen ne jemi të detyruar që të përdorim edhe 'facebukun' dhe mediat, sepse dyert po na mbyllen! Edhe nëse e parashtrojmë për zgjidhje një çështje nuk marrim përgjigje, nuk kemi përgjigje as për mbylljen e Bibliotekës në fshatin Bardh i Madh.

Drejtores e KRS-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me Bibliotekat në fshatrat Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe, më datë 31.08.2016 është marrë një vendim nga Kryetari i Komunës për bartjen e librave në shkollat e këtyre fshatrave dhe ne si Drejtori e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk kemi të bëjmë aspak me këtë pyetje.

Drejtori i Arsimit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Dua të përgjigjem në pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës, z. Driton Ademi, lidhur me çështjen e sigurisë në shkolla, e cila me përgjegjësi e them se është e kënaqshme, kur e marrim parasysh rrethin ku veprojmë, në një mjedis heterogjen me 35-40 nxënës në një klasë, në tri shkollat e mesme gjendja është e qetë. Kemi pasur vetëm dy rrahje, një brenda dhe një jashtë oborrit të shkollës, por jo me pasoja të rënda. Në shkollën e fshatit Vragoli na janë vjedhur katër kompjuterë dhe dëmi i shkaktuar është 2,000.00€, ne i kemi dërguar atje mjetet e punës, por nuk kemi roje natën, hulumtimi i organeve të rendit për këtë rast vazhdon. Shpesh mund të shihen grupe të rinjve që shëtisin përreth shkollës 'Selman Riza', ata janë edhe nxënës të shkollës së gjimnazit dhe ekonomisë, i dimë fjalët që fliten në opinion për përdorim të substancave narkotike, ne bëjmë kontrolle, por përveç duhanit nuk kemi hasur në gjëra tjera, ne nuk kemi përgjegjësi për ngjarjet jashtë objekteve shkollore. Kemi pak probleme me automjetet në oborret e shkollave 'Selman Riza' dhe 'Mihal Grameno' por çdo herë kur e ftojme Policinë ajo na përgjigjet, kemi një bashkëpunim të mirë me policinë. Çështja e dytë - greva e fundit e SBASHK-ut në shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës është përkrahur në tërësi, unë nuk jam përkrahës i grevave dhe shpesh nuk i kemi përkrahur qëndrimet e tyre, por kësaj radhe greva ka qenë e arsyeshme, sepse ka kërkuar njohjen e punës dhe kontributit të punëtorëve të arsimit në vitet 1990-1999, që kanë qenë edhe krenaria jonë në atë kohë dhe kjo punë nuk do koment.

Drejtori i GJKP: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës e ka regjistrin e pronave komunale, kjo punë është specifike, ju mund të kërkonit shënime për prona të caktuara por jo për të gjitha.

Drejtori i Inspektoratit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me importin e mishit me afat të skaduar asnjë ndërmarrje nga Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka mish të tillë, ky është informacioni zyrtar që e kemi. Deponia në fshatin Miradi e Poshtme, ata e kanë pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, inspektorët e tyre kanë qenë në terren, organet tjera e kanë ndaluar hedhjen e mbeturinave në atë vend, jeni i painformuar i nderuari anëtar i Kuvendit të Komunës.

Mehdi Lahu: Duhet të kyçeni në kontrollin e mishit, pyes a keni planifikuar që t'i kontrolloni dyqanet e mëdha?

Drejtori i Inspektoratit: Ne i bëjmë inspektimet e rregullta, kontrollet bëhen nga Inspektorët Komunalë dhe Inspektorët e Ministrisë së Shëndetësisë, kjo punë është alarmuar në tërë Kosovën, dhe dihet ku është gjetur ai mish.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e kam theksuar çështjen e ndarjes së dhjetë milionë eurove nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë për trajtimin e ujërave të zeza në territorin e Komunave të Prishtinës dhe Fushë-Kosovës, pyes - a përfitojnë të gjithë fshatrat e Komunës sonë? Po ashtu kërkoj që të vendosen laurat në vendet e rrezikshme ku kalohet hekurudha nga qytetarët e Komunës tonë. Ne e kuptojmë që kjo punë është e Kompanisë Infrakos, por duhet të bashkëpunojmë për t'i mbrojtur qytetarët tonë. Përfaqësuesit e shkollave nga viti 2012 janë trajnuar për t'i zhvilluar

procedurat e prokurimit me vlera minimale dhe kanë autonomi në këtë fushë. Pyes, a kryhen këto procedura nëpër shkollat e komunës tonë?

Doruntina Jashari: Unë e kam një replikë, ne kemi të drejtë ligjore që ta kemi komplet regjistrin e pronave komunale, ju i dini ku janë pronat e caktuara komunale, ne nuk i dimë, andaj e kërkojmë regjistrin e pronave komunale.

Drejtori i Arsimit: Prokurimi nëpër shkolla zhvillohet në komunat e mëdha siç janë Prishtina, Ferizaj, e tjera, por jo edhe në komunat e vogla siç jemi ne.

Pika e tretë (3) - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Për shqyrtim dhe vlerësim e kemi 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017' ku përfshihen në formën dhe përmbajtjen e detajuar të dhënave për punën dhe aktivitetet e drejtorive të komunës dhe në fund të Raportit të Punës është raporti në formën tabelore i Zyrës së Prokurimit i cili është i hapur dhe prezanton punën e kryer.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa ne i kemi dhënë vlerësimet tona dhe në 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017' e kemi theksuar se është bërë një punë e mirë. Raporti është shumë voluminoz dhe prezanton punën e Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017, premtimet e Kryetarit të Komunës për projekte publike janë realizuar dhe Grupi Parlamentar i LDK-së e aprovon punën e kryer.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Drejtori i Arsimit theksoi se gjendja është e kënaqshme, kjo është një paradoks! 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017' nuk është i standardizuar, kërkesa e Kryetarit të Komunës për shqyrtimin e raportit të punës nuk i përmbush as kërkesat minimale që duhet t'i ketë një Raport Pune! Raporti i Punës nuk është i strukturuar as në rrafshin horizontal, ka mungesë kontrolli, punë pa kriterë! Asamblistët e LDK-së, prej vendbanimeve të tyre nga vijnë, mundohen ta paraqesin punën si pozitive, por kjo në fakt nuk është ashtu! Nuk e kemi përpjekjen as më të vogël të auditivit të brendshëm për kontroll! Komiteti i Auditivit që duhet të jetë këshillëdhënës për menaxhmentin në punën e tij duhet të kenë qasje organet kompetente, hetuesia, prokuroria. Puna jonë është në aspektin politik ta evidentojmë, që Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës dhe raportet e drejtorive të komunës kanë një boshllëk të madh ndërmjet tyre dhe shërben vetëm sa për ta përmbushur një obligim ligjor. Shumica e pjesëve të raportit janë 'copy-pasty' te secila drejtori e komunës dhe kjo ndërlidhet me shpenzimet enorme dhe shumë të larta për dreka, darka, ushqim dhe derivate të naftës!

Mehdi Lahu: Arsimit në Komunën tonë lë shumë vend për të dëshiruar dhe nuk veprohet me vite, përkundër problemeve që i kemi me numrin e madh të nxënësve, 45 nxënës në një klasë, organizimi i mësimi në tri ndërrime, kjo u shkakton edhe probleme të mëdha prindërve për dërgimin e fëmijëve të tyre në shkollë! Në Raportin e Punës nuk përmenden fare ankesat që janë bërë lidhur me ndërtimin e objektit të ri shkollor të ndërtesat e 'Kompleksit 300' ku nuk janë plotësuar as kushtet bazike për ndërtim, shkolla ka filluar të ndërtohet pa leje, Inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i kanë ndërprerë punimet. As banorët nuk janë pajtuar me këtë formë të ndërtimit të objektit shkollor. Mësimdhënësit nuk mund të ofrojnë mësim cilësor me numër kaq të madh nëpër klasa! Vazhdon praktika e ndërtimit të objekteve publike jofunksionale. Mësimi për parashkollor zhvillohet vetëm në fshatin Lismir por jo në qytet, në lagjen e Nakaradës është dashur të ndërtohet një shkollë e cila do të shkarkonte shkollat e qytetit. Objekti shkollor në oborrin e Shkollës 'Daut Bogujevci' nuk është funksional, ndërtimi i një aneksi

në Shkollën 'Mihal Grameno' nuk krijon një zgjidhje afatgjate për zgjerimin e hapësirave shkollore, punohet 'ad hoc', pa plan të studiuar që i përshtatet nevojave të arsimit! Në qytet ekziston vetëm një çerdhe publike dhe dhjetë private, tri çerdhe publike - një në qytet dhe dy në fshatra, është tentuar të jepen me qira nuk ka pasur sukses, objekteve publike arsimore iu është ndërruar destinimi! Dërgimi i fëmijëve nëpër çerdhe private është i papërbalueshëm për prindër! Nxënësit nga distanca të largëta, siç është lagjja e 'Ronollëve' në fshatin Graboc i Poshtëm, nuk barten deri në shkollë, edhe pse këtë e parasheh ligji! Te Drejtoria e Administratës kemi ankesa të qytetarëve se nuk respektohet orari i punës, audioincizimet nuk publikohen në ueb-faqe, përfaqësuesve të Shoqërisë Civile nuk i lejohet qasja në dokumente publike! Për raportin e Drejtorisë së Planifikimit Urban kemi ankesa se rregullat e ndërtimit nuk zbatohen në terren, janë shkatërruar lagje të tëra, mungojnë parkingjet dhe hapësirat e gjelbra! Po të shfrytëzohej nga ndërtuesit prona për ndërtime sipas rregullave të lejuara ne tani do ta kishim një qytet model dhe do ta arrinim qëllimin për zhvillimin e qytetit. Ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk pajtohemi me ndërtimet e bëra në këtë mënyrë, ato duhet të ndalohen dhe të bëhen vetëm sipas rregullave dhe standardeve të lejuara për ndërtimin e objekteve të larta të banimit! Problem tjetër që i mundon qytetarët e Komunës tonë është uji i pijshëm, i cili është një premtim i parealizuar i Kryetarit të Komunës, që nga Zgjedhjet e vitit 2009. Po ashtu edhe në fushatën zgjedhore të vitit të kaluar ka pasur zotime se kyçja në rrjetin e ujit të pijshëm do të realizohet, është për të ardhur keq që banorët e lagjes së Bresjes ujin e pijshëm e bartin nga 'Baumarketi'.

Drejtori i Arsimit: Dua t'ia rikujtoj anëtarit të Kuvendit të Komunës, z. Driton Ademi, se unë fola për hapësirën e objekteve shkollore, jo për qytetin e Fushë-Kosovës, përdorimin e substancave narkotike jashtë shkollës ne nuk mund ta ndalim, ne nuk i menaxhojmë parqet e qytetit, ato janë punë e Policisë së Kosovës. Sa i përket diskutimit të anëtarit z. Mehdi Lahu ne e pranojmë se Shkolla 'Mihal Grameno' është e ngarkuar shumë për shkak të ardhjes së banorëve të rinj në ndërtesat e reja, në atë pjesë të qytetit nga të gjitha viset e Kosovës dhe jashtë saj. Ne kemi vepruar, kemi ndërtuar një aneks në oborrin e Shkollës 'Mihal Grameno', kemi filluar vitin e kaluar ndërtimin e objektit të ri shkollor të tipit të mbyllur të ndërtesat e 'Kompleksit 300' dhe për çudi kemi pasur pengesa! Sa i përket listës së pagave të punëtorëve arsimor kemi probleme sepse Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk lejon rritjen e personelit arsimor. Na është premtuar nga Ministri i Financave se këtë vit, me rishikimin e buxhetit, do të na lejohen edhe 20 vende të reja të punës në arsim, por kjo mbetet të shihet. Buxhetin e kemi të kufizuar, i kemi nëntë mësimdhënës që nuk kemi patur mundësi t'i fusim në listën e pagave, atyre ua kemi dhënë tri paga. Mësimi për parashkollor nuk zhvillohet vetëm në Lismir por edhe në disa fshatra tjera. Mësimi për parashkollor nuk është ende obligues siç thuhet në publik, ato komuna që e kanë - e zhvillojnë, ne nuk kemi mundësi buxhetore, sepse kemi rritje të madhe të numrit të nxënësve. Për ndërtimin e shkollës në lagjen e 'Nakaradës' kemi probleme me pronën, rasti është në procedurë gjyqësore, ne presim tetë vite për përfundimin e objektit të Shkollës 'Daut Bogujevci', shpresojmë që ky objekt shkollor do të përfundojë gjatë këtij viti! Në atë shkollë mësimi zhvillohet edhe në gjuhën serbe dhe mësimi për nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike. Çerdhet publike të ndërtuara më herët në fshatrat Bardh i Madh dhe Miradi e Poshtme nuk mund t'i funksionalizojmë, sepse duhen minimumi pesë vende pune për një çerdhe - tri edukatore, një gjellëbërëse dhe një pastruese. Ne nuk mund të ndikojmë në çmimin e çerdheve private, sepse atë e përcakton konkurrenca në treg, në çerdhen publike çmimi është 45€.

Transportin e nxënësve nga lagjja e 'Ronollëve' në fshatin Graboc i Poshtëm nuk e kemi anashkaluar, por nuk kemi patur kërkesa nga banorët për transport, ne i transportojmë nxënësit nga lagjja e 'Nakaradës' në Shkollën 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë, nxënësit nga lagjja 'Rafshinat' dhe fshati Bardh i Vogël në Shkollën 'Bajram Curri' në fshatin Sllatinë e Madhe dhe nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollën 'Përparimi' në Prishtinë.

Driton Ademi: Përgjigjen e pranoj, pa fjalinë e parë të cekur nga ju i nderuari Drejtor i Arsimit. Unë një kohë kam qenë edhe punëtor i juaji, substancat narkotike nëpër shkolla përdoren, nëpër klasa kundërmon erë e rëndë dhe këto janë fakte, siguria është kompetencë e policisë, por në objektet shkollore nuk kanë vend dukuritë negative! Ju nuk mund ta përdorni siç po e bëni metodën e mirënjohjeve për policinë, siguria duhet të jetë në shkollë brenda dhe në oborrin e shkollës.

Mehdi Lahu: Unë e kuptoj përgjigjen e Drejtorit të Arsimit që punën e ndërlihdh me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit, por trendin e rritjes së numrit të nxënësve e keni ditur, duhet të bëhen planifikimet sipas nevojave! Nuk duhet t'i pranoni në shkolla nxënësit që nuk ofrojnë dëshmi se janë banorë rezident në Komunën e Fushë-Kosovës, e njëjta duhet të vlejë edhe për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Nënkryetari i Komunës: Ne e kemi për analizë dhe vlerësim 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017' i cili paraqet objektivat të cilat janë realizuar 100%, temat tjera mund t'i trajtojmë si tema të veçanta. 'Raporti i Punës për vitin 2017' prezanton punët e kryera në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe fusha tjera. Sfidë për ne në vitin 2017 ka qenë grumbullimi i të hyrave vetjake, në shumë prej 3,000,000.00€, ku përveç - Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Kryetarit të Komunës, kemi reaguuar edhe si Kuvend i Komunës, i kemi drejtuar Ministrisë së Financave një shkresë zyrtare që të ulin tavanin e grumbullimit të të hyrave vetjake. Kryetari i Komunës ka patur një bisedë me Ministrin e Financave i cili ka premtuar se me rishikimin e buxhetit do të ofrojë një zgjidhje për rritjen e normave për njëzet mësimdhënës në Komunën e Fushë-Kosovës.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Shëndetësia në Komunën e Fushë-Kosovës është shembulli më tipik se si një pushtet keqëqeverisë! Gjendja në Qendrën Kryesore Shëndetësore është e keqe, objektet e ndërtuara shëndetësore pa plan janë jashtë funksionit, thuhet se kanë qenë donacione, shpenzimet janë bërë atje, doktorët nuk dërgohen nëpër këto objekte shëndetësore! Bëhet ngjyrosja e objekteve shëndetësore në Fushë-Kosovë, Bardh i Madh dhe Miradi e Poshtme që hyjnë në 'kategorinë e investimeve kapitale', kur shërbimet shëndetësore që ofrohen aty janë absurde, mungon termometri dhe gjërat elementare për shërbime shëndetësore! Orari i punës nuk respektohet, mjekët dhe motrat dalin në të njëjtën kohë në pauzë. Tualetet janë jashtë funksionit dhe burim i mundshëm për infeksione të shumta! Raporti me pacientët nuk është në nivelin e duhur, shumë raste dërgohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe në Qendrën Emergjente. Në Shërbimin e Stomatologjisë nuk mund të rregullohet asnjë dhëmb, pacientët udhëzohen nëpër ambulanca private!

Nënkryetari i Komunës: Konstatimi juaj se në shëndetësinë e Komunës së Fushë-Kosovës është gjithçka terr, është i pavërtetë. Në Shërbimin e Stomatologjisë mund të nxirren dhëmbët dhe pacientët e marrin trajtimin fillestar. Qendrat tjera shëndetësore nuk mund të funksionalizohen për arsye se kanë pak pacientë, nëse e marrim një javë të punës.

Unë, z. Driton Ademi, e mbroj atë që është reale dhe e saktë, punën që bëhet, sepse nuk është krejt e zezë siç po tentoni ta paraqitni disa anëtarë të Kuvendit të Komunës! Si mund të thuhet se

mungojnë shërbimet shëndetësore aty ku bëhen 160.000 mijë vizita shëndetësore! Mund të themi se jemi mbi mesataren e komunave tjera, pa asnjë dilemë që mbështetet në fakte.

Aida Alimi: Unë do të flas vetëm në vija të trasha sepse debati për këtë temë është konsumuar. 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017' është përshkrim i punëve dhe aktiviteteve të drejtorive të komunës, projektet e realizuara janë gjysmake, nuk specifikohet asgjë deri në fund, Raporti i Punës është voluminoz, por jo i specifikuar, punët e kryera përsëriten nëpër drejtori të caktuara!

Remzi Shala: Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa ne i kemi dhënë sugjerimet dhe kritikën tona, por edhe kritikën e kolegëve nga opozita janë të mira për përmirësimin e mëtejshëm në të ardhmen. Orari i punës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë respektohet, mjeku dhe një motër rrinë gjithmonë brenda edhe gjatë kohës së pauzës. Në Shërbimin e Stomatologjisë jepen këshillime bëhet edhe ngjitja e protezave, shërbimet ofrohen sikur në qendrat tjera shëndetësore nëpër Kosovë. Unë mendoj se edhe rregullimi i infrastrukturës së objekteve shëndetësore duhet të bëhet. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017', punën dhe projektet e realizuara, i vlerësojmë pozitivisht, sepse puna e bërë shihet edhe në terren.

Ali Ismaili: Shumë fjalë u thanë për 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017', secili nga këndi i vet i vlerësimit, por unë dua të them se nuk është puna krejtë e bardhë e zi, ka vende ku është punuar dhe rezultatet shihen, por ka edhe ngecje. Ka drejtori të komunës që Raportin e Punës për dymbëdhjetë muaj e paraqesin me pak rreshta, siç është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik. Na është premtuar se me Raportin e Punës do të na dorëzohet edhe Raporti për punësimin në Projektin e KARITAS-it, nuk kemi të dhëna të plota as për ndarjen e subvencioneve për shërim shëndetësor të rasteve në nevojë në shëndetësi, apo bursave për studime në arsim, subvencionet në bujqësi në vitet e kaluara janë publikuar. Në Raportin e Punës së Drejtorisë së Inspektoratit nuk kemi gjë të shqiptuara nga inspektorët në terren, kjo është e pa shpjegueshme! Marrë në tërësi, Raportit të Punës i mungojnë sfidat që i kanë pasur drejtoritë e komunës, andaj ne nuk kemi mundësi të ofrojmë shumë zgjidhje apo sugjerime për përmirësime në vitin e ardhshëm. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, pas dhënies së vlerësimeve për 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2017' nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, theksoi se Raporti i Punës pasqyron punën dhe projektet kapitale të realizuara në vitin 2017.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2017.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, analizë dhe vlerësim 'Propozimin për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2017', ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i FB-së: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. 'Raporti Financiar për buxhetin e vitit 2017' është bërë në bazë të 'Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë', 'Ligjit për Vetëqeverisje Lokale' dhe tri Rregulloreve të Thesarit, konform nëntëmbëdhjetë standardeve të kontabilitetit për ekzekutimin e buxhetit. Në Administratën Komunale buxheti i shpenzuar është në shumë të mjetëve financiare prej: 5,661,539.45€, buxheti i shpenzuar është 3,868,459.49€ dhe buxheti i mbetur është 1,793,079.96€, në arsim buxheti i alokuar është në shumë të mjetëve financiare prej: 3,465,786.86€, buxheti i shpenzuar është 3,422,488.03€ dhe buxheti i mbetur është 43,299.04€, në shëndetësi buxheti i alokuar është në shumë të mjetëve financiare prej:

1,318,945.93€, buxheti i shpenzuar është 1,215,176.11€ dhe buxheti i mbetur është 103,769.82€, në Zyrën e Komuniteteve buxheti i alokuar është në shumë të mjeteve financiare prej: 34,587.48€, buxheti i shpenzuar është 33,563.45€ dhe buxheti i mbetur është 1,034.03€. Totali i përgjithshëm për buxhetin e alokuar është në shumë të mjeteve financiare prej: 10,480,869.93€, buxheti i shpenzuar është 8,539,687.08€ dhe buxheti i mbetur 1,941,182.80€. Në fund, buxheti i shpenzuar në vitin 2017 arrin shumën e mjeteve financiare prej 8,539,687.08€ ose 81,48%, në raport me buxhetin e alokuar në shumë prej 10,480,869.93€. Struktura në përqindje në bazë të buxhetit të alokuar prej 10,480,869.93€ është si vijon: grandet qeveritare me 62,64%, të hyrat vetjake me 20,47%, saldo e bartur nga viti i kaluar me 15,56%, participimi i qytetarëve me 1,24% dhe donacionet me 0,09%. Të hyrat vetjake që u çekën edhe nga Nënkryetari i Komunës, të planifikuara për vitin 2017 kanë qenë 3,035,973.00€, ndërsa kemi arritur t'i realizojmë shumën e mjeteve financiare prej 2,260,027.13€ ose 74%. Sa i përket grumbullimit të të hyrave vetjake në vitin 2017 nuk kemi rënie, por tavanin i caktuar për grumbullimin e tyre nga Ministria e Financave ka qenë i lartë, këtë fakt ne e kemi kundërshtuar si Drejtori e Financave dhe Buxhetit, përmes shkresave zyrtare, të njëjtën gjë e ka bërë edhe Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, por nuk jemi marrë parasysh, caktimi i tavanit prej tre milionë eurove për Komunën tonë ka qenë joreal! Në Raportin Financiar të bashkëngjitur e keni edhe aspektin financiar të pasqyrës së shpenzimeve për Projektin e Punësimit me KARITAS-in dhe shpenzimet për varrime, që realizohen për secilën ceremoni të varrimit përmes Këshillit të Bashkësisë Islame.

Ali Ismaili: Për Organizatat Joqeveritare, KARITAS-in dhe Këshillin e Bashkësisë Islame, janë ndarë mjete financiare në shumë prej rreth një milionë euro për katër vjet dhe ne nuk e kemi asnjë raport financiar të kthyer nga to si anëtarë të Kuvendit të Komunës. Ne i ndajmë 250,000.00€ në vit për Projektin e punësimit me KARITAS-in, i dimë nga shënimet e Raportit të Punës se janë të punësuar pesëdhjetë punëtorë në shëndetësi, katër në arsim, të tjerë në administratë dhe shërbime publike, por nuk i dimë pagat e tyre, nuk e kemi listën e të punësuarve. Është vendosur njëherë një regjistrator 'follder' në dritare dhe është thënë: 'ja ku janë, merrni, shikoni, kjo nuk është në rregull, ne kërkojmë raport zyrtar! Nuk kemi raport për shpenzimin e mjeteve financiare as për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova', të cilit vitin e kaluar nga buxheti i komunës i kemi ndarë 38,000.00€, kështu nuk hiqen dyshimet tona.

Drejtori i FB-së: Shuma e mjeteve financiare për shpenzimet e varrimit është 40,000.00€, ndërsa për vazhdimin e Projektit të punësimit me KARITAS-in është 222,000.00€, pagat këtë vit i kemi harmonizuar, ka patur ndryshime sepse kemi patur edhe lëvizje të punëtorëve në katër sektor të ndryshëm, me kualifikime të ndryshme.

Durim Hajra: 'Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/dhjetor 2017' ka shumë shpenzime të paarsyeshme. Në zyrën e Kryetarit të Komunës për 'mallra e shërbime' janë shpenzuar 28,000.00€, ndërsa për gjithë administratën e komunës 1755€, kjo është vepër artistike, nuk ka specifikim për vlerat e shpenzimeve prej 1000€, apo shpenzime tjera! Shpenzimet për derivate të naftës në Zyrën e Kryetarit të Komunës janë të mëdha, për një automjet janë shpenzuar 15.54€ në ditë, apo shprehur në kilometra janë kaluar 238 kilometra, shpenzimet e mirëmbajtjes janë 3008€, pastaj për ushqim dhe pije 5000€! Në Drejtorinë e Inspektoratit kemi shpenzime për shërbime të varrimit. Nuk dihet ku është faji për shpenzimet e mëdha të derivateve të naftës, te shoferët e automjeteve, apo ku, sepse kjo është shndërruar në një dukuri interesante, për gjeneratorin e shkollës janë shpenzuar 14,000.00€, ndërsa shpenzimet e energjisë elektrike janë 28,000.00€, kjo është e pa-arsyeshme!

Drejtori i FB-së: Shumat e paraqitura të shpenzimeve në Raportin Financiar janë të sakta, ne kemi promutacion të shpenzimeve nëpër kodet e ndryshme ekonomike, sepse përndryshe nuk mund të

funksionojmë gjatë këtyre shtatëmbëdhjetë viteve. Buxheti na ndahet për 34000 mijë banorë, ndërsa ne ofrojmë shërbime përreth 55000 mijë banorë, andaj kemi shpenzime për shërbimet e varrimit edhe te Drejtoria e Inspektoratit. Buxheti nga viti 2005 apo 2006 ka qenë katër milionë tani është dhjetë milionë, për dymbëdhjetë vite neve na janë rritur vetëm dy vende të punës dhe kjo është e pa pranueshme, sepse nevojat për shërbime janë rritur. Shpenzimet për 'mallra dhe shërbime' janë 7.80%, prej Zyrës së Kryetarit të Komunës merren mjete financiare për shpenzime nëpër kode tjera dhe ky fakt e prish matematikën e shpenzimeve, në kuadër të shpenzimeve të derivateve të naftës hyjnë edhe shpenzimet për gjeneratorë në shkolla, objekte shëndetësore dhe objektin e komunës!

Durim Hajra: Unë po flas vetëm në bazë të dokumentacionit zyrtar që është përfshirë në Raportin Financiar, ku shpenzimet në fusha të caktuara janë të larta.

Aida Alimi: Mbetja e mjeteve financiare të pashpenzuara është e lartë, e në anën tjetër nevojat e qytetarëve për arsim dhe shëndetësi më të mirë nuk janë përmbushur. Destinimi i mjeteve financiare në arsim dhe shëndetësi paraqet një kaos të vërtetë, për të mos i përsëritur çështjet e njëjta për shpenzime të paarsyeshme që u cekën nga parafolësit. Për rritjen e buxhetit të komunës është dashur ta bëjmë regjistrimin e popullsisë të cilin ne e kemi kërkuar edhe në mandatin e kaluar.

Mirvete Gërguri: Tani shumë sqarime për buxhetin e shpenzuar u dhanë nga Drejtori i Financave dhe Buxhetit, mua më intereson të di ku janë pengesat kryesore për mosrealizimin e buxhetit për projekte kapitale, meqë e kemi një bartje të lartë të mjeteve financiare, a janë ato në nivelin qendror, për shkak të ndryshimit në procedurat e prokurimit, nga prokurimi manual, në prokurimin elektronik, ku shumica e institucioneve publike kanë patur vështirësi! Në arsim çerdhet publike duhet të funksionalizohen, sepse nevojat për to janë të mëdha për prindërit që punojnë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për aprovimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2017'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe katër 'abstenime', gjithsej njëzet e një (21) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2017' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për vitin 2017, në shumë të përgjithshme prej 8,539,687.08€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale buxheti i shpenzuar është në shumë prej 3,868,459.49€;
 - 2.2 Në arsim buxheti i shpenzuar është në shumë prej 3,422,488.03€;
 - 2.3 Në shëndetësi buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,215,176.11€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 33,563.45€.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e parë të taksës administrative dhe tarifës së densitetit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit për vitin 2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë 'Propozimin për caktimin e taksës administrative dhe tarifës së densitetit në infrastrukturë' për ndërhyrje në rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme, rrugëve, hapësirës së lirë, objekteve për arsim dhe shëndetësi për lëshimin e lejeve të ndërtimit në vitin 2018. Ftoj Drejtorin e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori i PU-së: Taksat për lëshimin e lejeve të ndërtimit për vitin 2018 janë aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. E para, taksa administrative për lëshimin e lejeve

ndërtimore është në shumë prej 2.25€, e dyta, tarifa rregulluese për rritjen e densitetit në infrastrukturë bëhet sipas formulës së zëbërthyer në tabelën që ju e keni marrë me material dhe llogaria del të jetë për vitin 2018 - në shumë prej 3.45€ dhe në total del se taksat për lëshimin e lejeve të ndërtimit për vitin 2018 është në shumë të përgjithshme prej 5.70€.

Driton Ademi: Tematika e ndërtimeve është pak e ndërlikuar, por në Komunën e Fushë-Kosovës është shkelur Ligji për Ndërtimet, standardet e parapara me atë ligj nuk janë respektuar, është shkelur kodi i ndërtimit, mungojnë hapësirat gjelbëruese, mungojnë shkallët për intervenime emergjente në objektet e banimit kolektiv! Në vend se të intervenojë Inspektorati i Komunës – ai hesht, që nënkupton se e pranon këtë mënyrë të ndërtimit pa kritere! Lidhur me Planet Rregulluese Urbane mungon transparenca, andaj Nisma Socialdemokrate nuk pajtohet me këtë mënyrë të ndërtimit të qytetit tonë!

Drejtori i PU-së: Sot kemi debat për caktimin e taksës komunale për lëshimin e lejeve të ndërtimit për vitin 2018. Ju jeni duke folur në ajër, Planet Zhvillimore Komunale dhe Planet Rregulluese Urbane janë publike, lejet e ndërtimit janë të publikuara në ueb-faqe. Ne tani jemi në proces të Hartimit të Hartave Zonale të Komunës, të cilat i definojnë dhe parashohin vendet për ndërtim dhe hapësirat gjelbëruese, deri në miratimin e Hartave Zonale të Komunës në Kuvendin e Komunës, ne punojmë në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban.

Mehdi Lahu: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrah ‘Propozimin për caktimin e taksës administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit për vitin 2018’ dhe kërkon që kjo taksë të rritet në mënyrë që të ndikohet pak në këtë proces. Numri i Inspektorëve Komunalë të Ndërtimit është i vogël, të ndalet pak ky hov i ndërtimeve pa kritere dhe ndërtimet të bëhen në përputhje me standardet e ndërtimit.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovimin në parim ‘Propozimin për caktimin e taksës administrative dhe tarifës rregulluese për rritjen e densitetit në infrastrukturë për lëshimin e lejeve të ndërtimit në vitin 2018’.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota ‘për’, një ‘kundër’ dhe asnjë ‘abstenim’, gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi në parim ‘Propozimin për caktimin e taksës administrative dhe tarifës rregulluese për rritjen e densitetit në infrastrukturë për lëshimin e lejeve të ndërtimit në vitin 2018’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim dhe dërgimin në diskutim publik të ‘Propozimit për caktimin e taksave administrative për vitin 2018, për lëshimin e lejeve ndërtimore, në shumë prej 2.25€ për një metër katror’.
2. Për aprovimin në parim dhe dërgimin në diskutim publik të ‘Propozimit për caktimin e tarifës rregulluese për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin 2018, për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 3.45€ për një metër katror’.

Pika e pestë (5) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit ‘Fushë-Kosova’.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit ‘Fushë-Kosova’, sipas kërkesës së specifikuar për shpenzime, të

cilës i është bashkëngjitur edhe qarkullimi bankar për shpenzimet njëvjeçare të Klubit të Futbollit, ftoj Drejtoren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të na jap sqarime.

Drejtor e KRS-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkesa e Klubit të Futbollit 'Fushë-Kosova' për ndihmë financiare në shumën e kërkuar prej 56,550.00€ është e arsyeshme. Klubi i Futbollit është klubi më masiv, sa i përket numrit të sportistëve të angazhuar. Është një klub që ka suksese, unë vetëm kërkoj që shuma e planifikuar për shpenzimin e mjeteve financiare prej 9,250.00€ të evidentuar në pozicionin e dytë për shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjeve futbollistike të hiqet, sepse është e mbuluar me marrëveshjen që Komuna e ka me Federatën e Futbollit të Kosovës. Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' momentalisht është në katër vendet e para në Ligën e Parë të Futbollit të Kosovës dhe duhet të përkrahet.

Remzi Shala: Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' duhet të përkrahet sepse ballafaqohen me vështirësi financiare, pajtohem që të tërhiqet shuma prej 9250€ që u cek nga Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' të përkrahet me mjete financiare në shumë prej 35,000.00€ sepse kaq e kemi ndihmuar edhe vitin e kaluar. Ne jemi që të rritet transparenca e shpenzimeve dhe të zgjedhen strukturat e reja të Klubit të Futbollit 'Fushë-Kosova'. Ne duhet të mendojmë që ta përkrahim edhe Klubin e Volejbollit të Femrave i cili po ashtu ka suksese.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne si Kuvend i Komunës edhe në mandatin e kaluar e kemi përkrahur shumë me mjete financiare Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova'. Ata e kanë bërë një kërkesë për ndihmë financiare, por klubi nuk ka Bord Udhëheqës të zgjedhur, aty momentalisht udhëheqin disa njerëz. Unë jam që kjo kërkesë për ndihmë financiare të shtyhet deri në zgjedhjen e udhëheqjes së re legjitime të klubit. Ata i shtyjnë zgjedhjet. Disa njerëz që punojnë aty duhet t'i vlerësojmë shumë për punën që bëjnë, i mban vetëm vullneti. Klubi udhëhiqet për një kohë të gjatë nga Nysret Rexhepi të cilin të gjithë e njohim, ai nuk e jep nënshkrimin në kërkesën për mjete financiare për klubin. Pranë organeve gjyqësore ka akuza që mjetet financiare nuk janë përdorur në të mirën e klubit, pas zgjedhjeve të reja në klub. Unë jam që të përkrahet klubi nga të gjithë ne, në mënyrë unanime, dhe të ndihmohet financiarisht. Fushën e ka mbuluar bari, po të mos ishin disa punëtorë të komunës të cilit kujdesen, nuk do të kishte mundësi të zhvilloheshin aktivitetet sportive. Aty nganjëherë janë edhe deri në 2000 shikues të cilët ia duan të mirën këtij Klubi të Futbollit. Anëtar i Kuvendit të Komunës, z. Jetmir Berisha, është në dijeni se lojtarët i marrin vetëm nga 150€ dhe në mënyrë jo të rregullt. Për udhëheqjen e klubit duhet të gjendet një njeri i ri, sepse ky njeri që ju e njihni, merr punë për vite të tëra nga Komuna, nuk e jep nënshkrimin, nuk punon, i duhet për ngritjen e klubit, klubi po dëmtohet pa udhëheqje të zgjedhur në një proces të rregullt dhe sipas kriterëve të vendosura paraprakisht! Pyes, njerëzit që nuk e duan sportin pse rrinë aty? Vitin e kaluar ka qenë një udhëheqje e përkohshme në krye me Shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së z. Nazmi Kelmendi dhe sa ka qenë ai është punuar mirë, edhe unë, bashkë në udhëheqje, e kam përkrahur z. Nazmi, kemi kërkuar ndihmë edhe nga bizneset, por ata thonë deri sa është aty z. Nysret Rexhepi askush nuk e përkrah klubin. Propozimi im është që deri në zgjedhjen e Bordit të ri Udhëheqës Klubi i Futbollit të përkrahet me 6,000.00€ - për ta kaluar këtë fazë të garave, meqë jemi në mes të sezonit garues dhe në fazën kyçe të tij.

Albert Jasharaj: Unë pyes z. Migjen Kolshi, cili është faji i Bordit të Klubit këtu që z. Nysret Rexhepi nuk e jep nënshkrimin?

Drejtores e KRS-së: Ne nuk e kemi asnjë dorëheqje, udhëheqja e tanishme për ne është legjitime deri në Kuvendin e ardhshëm zgjedhor.

Migjen Kolshi: Ju e dini mirë kush zgjedhet në atë Kuvend në strukturën udhëheqëse të klubit.

Mehdi Lahu: Ne si Lëvizje Vetëvendosje jemi që të ndihmohet Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' i cili është krenaria e qytetit, por duhet ta kemi një projekt detal se si shpenzohen mjetet financiare të ndara nga buxheti i Komunës! Aty duhet të punohet në kohë afatgjate për zhvillimin e klubit, të njihet statuti i klubit, të dihet kush është aksionar, jam që t'i jepet një ndihmë emergjente dhe propozimi të përkrahet në parim. Këtu kërkohet që t'i ndahen klubit 35,000.00€, pa patur një Bord Udhëheqës! Ju duhet ta dini se ne i kemi edhe disa klube tjera - Klubin e Futbollit nga fshati Miradi e Epërme. Kërkojmë që në të ardhmen të mos na dorëzohet për shqyrtim kësi lloj dokumenti, të hartuar në kafene, ku kërkohen 56,500.00€!

Ali Ismaili: Tani e dimë se gjendja ekzistuese në klub nuk është e mirë, edhe vitin e kaluar i kemi ndarë 38,000.00€ për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova' por nuk e kemi një raport zyrtar se si janë shpenzuar këto mjete financiare! Me mjetet financiare të ndara vitin e kaluar është dashur që lojtarëve t'iu blihen pajisje sportive, kopaçe, kam dëgjuar se ata nuk kanë pajisje sportive! Z. Migjen Kolshi e shpjegoi shumë drejt gjendjen ekzistuese! Ne e kemi ndihmuar vetëm këtë klub me vendim të Kuvendit të Komunës, si klubin më të madh sportiv, klubet tjera janë ndihmuar nga Kryetari i Komunës. Kuvendi nuk ka asnjë buxhet, ky klub është ndihmuar vazhdimisht çdo vit dhe asnjëherë nuk kemi patur raport zyrtar për shpenzimin e mjeteve financiare të ndara nga buxheti i Komunës. Unë propozoj që njëherë t'i ndajmë 20,000.00€, nuk duhet t'i hyjmë në hak edhe klubeve tjera, siç është Klubi i Volejbollit të Femrave. Për secilën fushë kur ndahen mjete financiare duhet ta kemi një plan menaxhues. Deri tani i kemi ndarë mbi 200,000.00€ për ndërtimin e sallave, është dashur të mendohet për mirëmbajtjen e tyre sepse mirëmbajtja është problem dhe kushton relativisht shumë. Ne duhet të ulemi pesë minuta dhe të vendosim për këtë çështje! E kemi edhe propozimin tjetër ku kërkohet ndihma financiare prej 5,000.00€ për vajzën e klasës së parë për ta ndihmuar atë që të lëviz më lehtë deri në shkollë dhe anasjelltas. Duhet të kemi kujdes para marrjes së vendimeve për ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i Komunës.

Migjen Kolshi: Aty dihen emrat që kanë përgjegjësi dhe që e kanë shkatërruar Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova', edhe shikuesit janë larguar nga tribuna, sepse ata kanë të drejtë ta shikojnë një klub që zhvillohet. Ne e kemi qëllimin e mirë, që ta përkrahim klubin dhe të ndryshohet gjendja ekzistuese.

Driton Ademi: Këtu ekziston një përvojë e keqe në raport me ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i Komunës për Organizatat Joqeveritare, nuk ka kthim të raporteve për shpenzimet e realizuara prej këtyre organizatave. Administrata publike duhet të bëjë thirrje për përkrahjen e Organizatave Joqeveritare nga 'kategoria ekonomike e subvencioneve', sipas kriterëve të caktuara paraprakisht, për këtë punë ekziston Rregullorja Nr. 03/2015. Klubi i Futbollit është regjistruar në bazë të akteve normative në Departamentin e Sportit në kohën e UNMIK-ut. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka asgjë çka të specifikojë këtu, klubi e ka statutin e vet, duhet ta ketë 'Rregulloren për mbikëqyrjen e shpenzimeve', nuk duhet të përkrahet financiarisht kur nuk ka raport zyrtar për shpenzimin e mjeteve financiare të ndara vitin e kaluar! Ndarja e subvencioneve auditohet, klubi sportiv është privat, lidhur me këtë çështje shikoni Ligjin për Lirinë e Asociimit dhe formimin e Organizatave Joqeveritare, aty e gjeni mënyrën se si funksionojnë ato.

Betim Ahmeti: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Me Migjenin, Naserin, kemi qenë pjesë e asaj që kemi dhënë vetë mjete vetjake për ta përkrahur sportin, jemi një familje që çdo herë e kemi përkrahur sportin, gjendja ka ardhur deri aty, por kjo situatë duhet të zgjidhet në Kuvendin Zgjedhor si organ më i lartë i Klubit të Futbollit 'Fushë-Kosova'. Tani për shkak të problemeve aktuale klubi nuk e meriton të ndëshkohet, unë jam që të përkrahet dhe të merret një vendim për ndarjen e mjeteve financiare.

Migjen Kolshi: Unë e vlerësoj fjalën e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Betim Ahmeti, nuk jam kundër përkrahjes së klubit, por duhet të mendohet për një zgjidhje afatgjate, jo 'ad hoc', të përkohshme.

Jetmir Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, e para, sportin ne e kemi traditë familjare, Klubi i Futbollit është klubi më masivi në Komunë dhe duhet të përkrahet, aty aktivitetin sportiv e zhvillojnë mbi 200 të rinj, klubi i ka njëzet lojtarë, të cilët këtë sezon kanë sukses në garat kampionale. Unë për dy vite punoj vullnetarisht në shkollën e futbollit, i vlerësojmë fjalët që i thanë kolegët, Betimi dhe të tjerët, jemi që të ketë raporte financiare për shpenzimin e mjeteve të ndara nga buxheti i Komunës. Për një kohë të caktuar atje është deleguar z. Nazmi Kelmendi dhe puna ka funksionuar mirë. Komuna jonë për sportin ka punuar shumë, nuk ka fshat pa fushë me bari sintetik, ku të rinjtë mund të arsyetohen dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre sportiv. Mjetet e shpenzuara në të kaluarën duhet të arsyetohen, të ketë një bashkëpunim me drejtorinë përkatëse për sport. Për dy vite është shtyrë mbajtja e Kuvendit të Klubit, tani pas dy jave është paraparë që të mbahet Kuvendi për zgjedhjen e udhëheqjes së re të klubit, për këto shkaqe na janë larguar edhe donatorët! Mendoj se janë duke ardhur ditë të mira për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova' prandaj edhe e përkrah Propozimin që Klubit të Futbollit 'Fushë-Kosova' t'i ndahen mjete financiare në shumë prej 35,000.00€.

Durim Hajra: Unë i dëgjova me kujdes parafolësit e mi dhe pajtohem që Klubi i Futbollit 'Fushë Kosova' në parim të përkrahet, por raporti për shpenzimet të jetë i specifikuar në periudha. Kjo pikë e rendit të ditës mund të shtyhet deri në mbledhjen e ardhshme, në ndërkohë, siç e ceku edhe z. Jetmir Berisha, formohen organet e reja të klubit dhe ne si Kuvend i Komunës e marrim vendimin për përkrahjen financiare të Klubit të Futbollit.

Nënkryetari i Komunës: Në klub ka pak probleme, mirëpo ne tani jemi para dy alternativave për zgjidhje. Po i përmendni zhvillimet që janë jashtë teme dhe nuk janë në kompetencën tonë, shpenzimi i mjeteve financiare vlerësohet nga organet përkatëse. Funksionimi i klubit nuk duhet të pengohet nga tekat e njerëzve të caktuar, nuk duhet të kemi dilema se a duhet të ndahen mjetet financiare apo jo! Për një muaj do të krijohen organet e reja të klubit, ne mund t'i ndajmë mjetet financiare, ekzekutimin e vendimit ta bëjmë pas formimit të organeve të reja të klubit, por jo ta pengojmë zhvillimin e klubit në kulmin e sezonit të garave kampionale.

Migjen Kolshi: Unë mendoj se nuk duhet të ndahet asnjë shumë e mjeteve financiare pa krijimin e organeve të reja të Klubit të Futbollit 'Fushë-Kosova'.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 35,000.00€, për Klubin e Futbollit "Fushë-Kosova".

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', tri 'kundër' dhe një 'abstenim', gjithsej njëzet (20) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 35,000.00€, për Klubin e Futbollit "Fushë-Kosova" dhe mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 35,000.00€, për Klubin e Futbollit "Fushë-Kosova", për t'i ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës në Futboll, për sezonin pranveror të Kampionatit 2017-2018 dhe sezonin vjeshtor të Kampionatit 2018-2019.
2. Mjetet financiare të lejuara në pikën një të vendimit, në shumë të përgjithshme prej 35,000.00€, do të shpenzohen dhe destinohen për nevojat e funksionimit të Klubit të Futbollit "Fushë-Kosova", si: mbarëvajtjen e garave kampionale, transferet e lojtarëve, mirëmbajtjen e zheshtores, pagesën e shërbimeve publike, blerjen e pajisjeve sportive, transport, akomodim, ushqim, pije dhe shpenzime tjera për klubin.

Pika e shtatë (7) - Propozim për fillimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunave italiane Civita dhe Frascineto.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për fillimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunave italiane Civita dhe Frascineto' ftoj Drejtoren e Administratës që t'na jap sqarime.

Drejtores e Administratës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo është një iniciativë e mirë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që kërkon të fillohet bashkëpunimi komunal ndërkombëtar, ndërmjet Komunave të Fushë-Kosovës e Lipjanit nga Republika e Kosovës dhe Komunave të Italisë Civita dhe Frascineto. Bashkëpunimi do të realizohet në fushat e arsimit, kulturës dhe fusha tjera në projekte të ndryshme, ju ftoj që ta votoni këtë 'Propozim për arritjen e marrëveshjes për binjakëzim.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për fillimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunave italiane Civita dhe Frascineto'.

U votua unanimisht nga pranishmit, gjithsej njëzet (20) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet, e aprovoi 'Propozimin për fillimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunave italiane Civita dhe Frascineto' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës së Fushë-Kosovës për fillimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunave të Italisë - Civita dhe Frascineto.
2. Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar do të zhvillohet në bazë të rregullave ligjore në fuqi, sipas parimeve, kushteve, kufizimeve dhe procedurave të caktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ndërmjet:
 - 2.1 Komunës së Fushë-Kosovës nga Republika e Kosovës dhe
 - 2.2 Komunave të Republikës së Italisë, Civita dhe Frascineto.

Pika e tetë (8) - Propozim për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë', ftoj Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës që të na jap sqarime.

Drejtori i GJKP-së: Ne e kemi një kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë që mundëson themelimin e Degës së Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë, me çka shërbimet gjyqësore do të ofrohen më afër për banorët e Komunës tonë. Prona komunale që ne mendojmë ta ndajmë është sipërfaqja e lirë prej 9,72m² dhe gjendet këtu prapa banesave, kemi menduar që këtë sipërfaqe ta japim në shfrytëzim për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke iu lejuar atyre mundësinë, që nëse kanë pajtueshmëri, ta ndërtojnë një objekt të përbashkët me dy hyrje të ndara, në Ngatrën Kadastrale Nr. 01209-0.

Mehdi Lahu: Ne e përkrahim këtë propozim në parim, mirëpo hapësira aty është shumë e vogël, duhet të bëhet një analizë e mirë se a mund të ndërtohen aty dy objekte publike, sepse aty nuk ka hapësirë as për një gjysmë projekti të vogël! Ofrimi i shërbimeve administrative dhe gjyqësore më afër qytetarëve është i mirë dhe duhet të gjendet zgjidhje.

Aida Alimi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të PDK-së jemi për aprovimin e 'Propozimit për ndarjen e lokacionit për objektin e Degës së Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë'.

Drejtori i GJKP-së: Sqaroj se Ngatra Kadastrale në tërësinë e saj i ka gjithsej 73 ari tokë, por në kuadër të saj hyjnë edhe tri objektet banesore, ne e japim në shfrytëzim vetëm hapësirën prapa banesave.

Sabit Bullatovci: E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës unë në këtë rast nuk pajtohem me mendimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, si individ. Objekti publik për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Gjykata nuk mund të vendosen në atë hapësirë të vogël, ju po luani me neve, ne kemi vende tjera për ndërtimin e objektit të Gjykatës. Ka sipërfaqe të lira në fshatin tim Miradi e Poshtme, por edhe në qytet ka hapësirë. Ne e kemi dhënë një ar për dhjetë ar dhe kemi bërë zgjidhje për objektin e Qendrës për Punë Sociale, zgjidhje ka. Në fshatin Miradi e Poshtme është ndërtuar Salla e Sporteve që është donacion nga Komisioni Evropian, është paraparë të ndërtohet po ashtu edhe një Palestër Sportive për sportet që luhen me dorë, hapësirat ekzistojnë por duhet të ketë një menaxhim më të mirë dhe mos t'i mbyllim sytë, por të ofrojmë zgjidhjet më të mira!

Mehdi Lahu: Në fillim ne e përkrahëm këtë propozim në parim por kërkojmë që t'i dimë pronat komunale! Ne nuk i dimë sikurse i di anëtari i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci dhe Ekzekutivi i Komunës, andaj meqë nuk po na ofrohen informata nga Ekzekutivi i Komunës, ne e ndërrojmë qëndrimin tonë dhe për këtë arsye nuk mund ta përkrahim propozimin në fjalë!

Betim Ahmeti: Ne si subjekt politik i AAK-së e përkrahim 'Propozimin për ndërtimin e Degës së Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë', sepse shërbimet publike gjyqësore dhe administrative ofrohen më afër për banorët e Komunës tonë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për

Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë', me mundësinë që objekti të ndërtohet me dy hyrje, nëse pajtohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe katër 'abstenime', gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë', me mundësinë që objekti të ndërtohet me dy hyrje, nëse pajtohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme' dhe mori:

V E N D I M

1. Për dhënien në shfrytëzim të një pjese të caktuar të pronës komunale, në sipërfaqe prej $S=500m^2$, me destimin për ndërtimin e objektit publik për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë nga Ministria e Drejtësisë, e cila është pjesë e Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0, me sipërfaqe të lirë prej $S=952m^2$, e evidentuar në numrin e njësisë kadastrale Nr. 72514036-01209-0, të datës 19.03.2018 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, në kuadër të sipërfaqes së tërësishme të pronës komunale prej $S=7366m^2$.
2. Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës e lejon të hapur mundësinë që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të ndërtojnë një objekt të përbashkët publik, me hyrje të ndara, në sipërfaqen e lirë të pronës komunale të dhënë në shfrytëzim prej $952m^2$.

Pika e nëntë (9) - Propozim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Fushë-Kosovë', me mundësinë që objekti të ndërtohet me dy hyrje, nëse pajtohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe tri 'abstenime', gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të pjesës së caktuar të Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0 për ndërtimin e objektit për Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Fushë-Kosovë', me mundësinë që objekti të ndërtohet me dy hyrje, nëse pajtohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë' dhe mori:

V E N D I M

1. Për dhënien në shfrytëzim të një pjese të caktuar të pronës komunale, në sipërfaqe prej $S=452m^2$, me destimin për ndërtimin e objektit publik për Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Fushë-Kosovë nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila është pjesë e Ngatrës Kadastrale Nr. 01209-0, me sipërfaqe të lirë prej $S=952m^2$, e evidentuar në numrin e njësisë kadastrale Nr. 72514036-01209-0, të datës 19.03.2018 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, në kuadër të sipërfaqes së tërësishme të saj prej $S=7366m^2$.

2. Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës e lejon të hapur mundësinë që Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë të ndërtojnë një objekt të përbashkët publik, me hyrje të ndara, në sipërfaqen e lirë të pronës komunale të dhënë në shfrytëzim prej 952m².

Pika e dhjetë (10) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për palën Delfina Lavdim Shala.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndihmë financiare për shërimin e vajzës së klasës së parë Delfina Shala. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Në bazë të kërkesës vërehet se gjendja socio-ekonomike e familjes është e rëndë, andaj kërkojmë që këtu ta kemi një lloj fleksibiliteti, të shikohen mundësitë e bashkëpunimit me familjen për sensibilizimin e kësaj pune, sepse kostoja financiare për shërim është e lartë. Unë mendoj se një Komision Profesional nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mund të angazhohet që të sigurojë diçka edhe nga donatorët apo shoqatat, që të ofrojnë ndihmë në raste të tilla. Ne pajtohemi që propozimi në fjalë të aprovohet.

Eglantina Azemi: Ne, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje pajtohemi që të ndahen mjetet financiare për shërimin shëndetësor dhe blerjen e karrocës elektrike për lëvizjen më të lehtë të vajzës së klasës së parë Delfina Shala, por të shikohen edhe mundësitë e tjera për sigurimin e ndihmës nga donatorët. Ne nuk kemi informacione zyrtare se sa raste të tilla janë në Komunën tonë, meqë duhet të jemi të barabartë kur ofrojmë ndihmë për qytetarët e Komunës sonë.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi se duhet të ketë një Komision Profesional nga Drejtoria e Shëndetësisë që duhet të merret me rastet e tilla të rënda, që janë një barrë e madhe dhe e pa përballueshme për familjen. Rasti i vajzës Delfina Shala është një rast i prekshëm, ku duhet të vihet në pah ndihma e shoqërisë, ajo trajtohet dhe ndihmohet edhe nga nxënësit e tjerë, t'i sigurohet një karrocë elektrike për lëvizjen më të lehtë. Unë mendoj se për rastet e tilla të personave me aftësi të kufizuara duhet të jemi më të hapur edhe kur është në pyetje punësimi. Pajtohem që 'Propozimi për lejimin e mjeteve financiare, në shumë prej 5,000.00€, të përkrahët për aprovim.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e përkrahim këtë iniciativë për ta ndihmuar financiarisht shërimin e vajzës Delfina Shala. Unë vetë e kam ndihmuar që të hyjë në shkollë kjo vajzë, është një rast i rëndë që meriton të ndihmohet.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare, në shumë prej 5,000.00€, për palën Delfina Lavdim Shala', me mundësinë që të lejohen mjete financiare shtesë nga Kryetari i Komunës, për shërimin e vajzës së klasës së parë Delfina Shala.

U votua unanimisht nga pranishmit, gjithsej njëzet (20) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare, në shumë prej 5,000.00€, për palën Delfina Lavdim Shala', me mundësinë që të lejohen mjete financiare shtesë nga Kryetari i Komunës, për shërimin e vajzës së klasës së parë Delfina Shala dhe mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare, në shumë prej 5,000.00€, për palën Lavdim Shala, për mbulimin e shpenzimeve për vajzën e tij shtatë vjeçare Delfina Shala, e cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Partus temporarius spontaneus. EMLD. Sutt. Liquar amnii meconialis. Spina biffida aperta Cheiognatopalatoschisis.

Pika e njëmbëdhjetë (11) – Propozim për ndarjen e Mirënjohjes për veprimtarin Rexhep Gunduz.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndarjen e Mirënjohjes për veprimtarin e respektuar z. Rexhep Gunduz, me prejardhje nga Kosova'. Rexhep Gunduz ka dhënë kontributin e tij në fushën e arsimit dhe kulturës, duke ndikuar që të ruhen lidhjet e banorëve të shpërngulur nga viset shqiptare në Turqi me vendlindjen. Ftoj Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori i Arsimit: Veprimtari i njohur z. Rexhep Gunduz në moshën trevjeçare është shpërngulur në Turqi, tani është 67 vjeçar, ka shërbyer në Akademinë Ushtarake të Turqisë. Është me origjinë nga Gjilani dhe ka shërbyer si urë lidhëse për qytetarët e Kosovës dhe Maqedonisë, për t'i ruajtur lidhjet me vendlindjen, e ka ndihmuar televizionin 21 nëpër vizita në tërë territorin e Turqisë, duke shkuar në tetëdhjetë fshatra të pastra shqiptare. Është nderuar edhe nga Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova. Neve na ka ndihmuar që shkollat tona të binjakëzohen me shkollat e qytetit të Bursës në Turqi. Është një njeri i palodhshëm dhe e meriton që ne si Kuvend i Komunës ta nderojmë me një Mirënjohje si vlerësim për kontributin e tij.

Mehdi Lahu: Cili është kontributi i tij për Komunën tonë që ne do të mund ta vlerësojmë?

Drejtori i Arsimit: Unë i theksova më herët virtytet e tij si personalitet, po ashtu ka qenë edhe pjesëmarrës në luftën turko-greke dhe është nderuar me merita si Veteran i Luftës.

Driton Ademi: Në propozimin e dhënë për shqyrtim nuk ka asgjë që këtë person e lidh me karakterin lokal, nuk lidhet në asnjë pikë me Fushë-Kosovën, kontributi i tij duhet të vlerësohet në nivelin kombëtar! Nisma është kundër justifikimeve të paarsyeshme dhe formalizmave, ne kemi plotë personalitete tona që duhet t'i nderojmë për kontributin e dhënë në Komunën e Fushë-Kosovës!

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ndarjen e Mirënjohjes për veprimtarin e respektuar z. Rexhep Gunduz, me prejardhje nga Kosova'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe tri 'abstenime', gjithsej tetëmbëdhjetë (18) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për ndarjen e Mirënjohjes për veprimtarin e respektuar z. Rexhep Gunduz, me prejardhje nga Kosova' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndarjen e Mirënjohjes për veprimtarin z. Rexhep Gunduz i shpërngulur në qytetin Bursa të Turqisë në vitet e pesëdhjeta të shekullit XX.
2. Veprimtari Rexhep Gunduz në vitin 1999 themeloi Shoqatën e Shqiptarëve të shpërngulur nga trojet etnike shqiptare me emrin 'Kosova-Uskup', e cila ka dhënë kontribut në strehimin e shqiptarëve të depërtuar nga Kosova dhe forcimin e lidhjeve të shqiptarëve me origjinë nga trojet etnike shqiptare që jetojnë në Turqi me vendin e origjinës.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete', me pajtimin unanim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës prej nëntë anëtarëve, ku duhet të respektohet kriteri gjinor. Ju ftoj që t'i jepni propozimet tuaja.

Remzi Shala: Pasi që kërkohet plotësimi i kriterit gjinor në përfaqësim, ne, Grupi Parlamentar i LDK-së, përveç znj. Arjeta Jashari, e propozojmë edhe znj. Miranda Shabani.

Aida Alimi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të PDK-së për anëtar të Komitetit për Komunitete e propozojmë z. Migjen Kolshi.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për themelimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete', në përbërje prej nëntë anëtarëve, si vijon: Arjeta Jashari, Miranda Shabani, Migjen Kolshi, Durim Hajra, Ljubisa Cirkovic, Rexhep Hyseni, Fehmi Gashi, Snezhana Karadzic dhe përfaqësuesen e komunitetit egjiptian e dorëzon emrin anëtari i Kuvendit të Komunës z. Bashkim Krasniqi.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe asnjë 'abstenim', gjithsej njëzet (20) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për themelimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete', në përbërje prej nëntë anëtarëve, si vijon: Arjeta Jashari, Miranda Shabani, Migjen Kolshi, Durim Hajra, Ljubisa Cirkovic, Rexhep Hyseni, Fehmi Gashi, Snezhana Karadzic dhe përfaqësuesen e komunitetit egjiptian e dorëzon emrin anëtari i Kuvendit të Komunës z. Bashkim Krasniqi dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej nëntë anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Arjeta Jashari - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.2 Miranda Shabani - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.3 Migjen Kolshi - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.4 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.5 Ljubisa Cirkovic - përfaqësues i komuniteti serb nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar;
 - 1.6 Rexhep Hyseni - përfaqësues nga komuniteti ashkali, anëtar;
 - 1.7 Emine Murtezi - përfaqësuese nga komuniteti egjiptian, anëtar;
 - 1.8 Fehmi Gashi - përfaqësues nga komuniteti rom, anëtar;
 - 1.9 Snezhana Karadzic - përfaqësuese e komunitetit malazez, anëtare.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës për mandatin zgjedhor 2017/2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për pjesëmarrje në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës për mandatin zgjedhor 2017/2021, me përfaqësimin e tri subjekteve më të mëdha politike në Kuvendin e Komunës me nga një përfaqësues, LDK-ja, PDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje'. Kryetari i Komunës merr pjesë sipas detyrës zyrtare. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Tani u theksua një çështje e specifikuar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, pa keqkuptime, formula e shpikur që po tentohet të vendoset lidhur me përfaqësimin tonë nga LDK-ja, PDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje, pa të drejtë, duke e eliminuar debatin! Nisma është kundër këtij formalizmi procedural nga ana juaj dhe për përfaqësim të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës e propozon z. Betim Ahmeti.

Remzi Shala: Grupi Parlamentar i LDK-së i respekton marrëveshjet që arrihen në Kuvendin e Komunës, por kësaj radhe nuk mundemi, sepse për përfaqësimin tonë në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës e propozojmë anëtarin tonë më të vjetër z. Sabit Bullatovci.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e propozojmë znj. Aida Alimi

Mehdi lahu: Ne e propozojmë Durim Hajra

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për pjesëmarrje në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2017/2021, në përbërje prej tre anëtarëve: Sabit Bullatovci, Aida Alimi dhe Durim Hajra'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë 'abstenim', gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për pjesëmarrje në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2017/2021, në përbërje prej tre anëtarëve: Sabit Bullatovci, Aida Alimi dhe Durim Hajra' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2017/2021, në përbërje prej tre anëtarëve: Sabit Bullatovci, Aida Alimi dhe Durim Hajra'.

Pika e katërmëdhjetë (14) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Betim Ahmeti: Unë propozoj që gjatë muajit prill anëtarët e Kuvendit të Komunës të shkojnë në një seminar në Shqipëri dhe të vazhdohet tradita e anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga mandatet e kaluara, kjo të jetë një vizitë e njëjtë si në të kaluarën, sepse ne jemi anëtarë të rinj dhe na nevojitet të shkëmbejmë përvoja me ndonjë bashki në Shqipëri.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', tri 'kundër' dhe dy 'abstenime', gjithsej njëzet (20) anëtarë. Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë' dhe mori:

V E N D I M

Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë

Aida Alimi: Në emër të Grupit të grave asambliste kërkoj që nxënësve të familjeve të dëshmorëve nga Komuna jonë t'iu jepen bursa për studime, sepse ata tani i mbushin tetëmbëdhjetë vjet dhe numri i tyre nuk është i madh, mund të mbulohet financiarisht nga buxheti i komunës.

Arjeta Jashari: Grupi i grave asambliste e përkrah këtë propozim.


Bashkim Krasniqi: Pse nuk po vendoset të votohet Nënkryetari i Komunës për Komunitete, ne e kemi një marrëveshje me përfaqësuesin e komunitetit serb në Kuvendin e Komunës dhe kandidatin tonë për pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.

Nën kryetari i Komunës: 'Propozimi për emërimin e Nënkryetarit për Komunitete' do të jetë në rendin e ditës në mbledhjen e muajit prill.

Nënkryetari i Komunës: Kjo punë do të zgjidhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe juve si propozues, ata e bëjnë regjistrin dhe kjo punë realizohet.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 13:15 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

